



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT  
KËSHILLI BASHKIAK  
BERAT**

**V E N D I M**

**NR. 60 Datë 18 / 12 / 2019**

**PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË  
BERAT**

Mbështetur në gërmën "f" të nenit 54, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, ligjit nr.107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, ligjit 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", ligjit 24/2017, "Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit", ligjit nr.10465, datë 29.09.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM nr.970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", i ndryshuar dhe akteve nënligjore të nxjerra për zbatimin e ligjeve të sipërcituara,

**VENDOSI**

1. Miratimin e taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Berat, sipas materialit bashkëlidhur këtij projektvendimi.
2. Vendimi i Këshillit Bashkiak Berat nr.57, datë 28.12.2015, "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Berat", i ndryshuar.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen drejtoritë, njësitë vartëse dhe njësitë administrative të Bashkisë Berat .

**I. TAKSAT VENDORE**

**1. TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL**

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Të ardhurat gjithsej nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u

kufizuar vetëm në to: të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.

## **KATEGORITË DHE NIVELI**

1. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 5 për qind.
2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) milionë lekë, është 0 (zero) lekë në vit.

### **Sqarime:**

1. Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore ose në Postën Shqiptare, këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës 20 prill, për muajt: janar, shkurt e mars; brenda datës 20 korrik, për muajt: prill, maj e qershor; brenda datës 20 tetor, për muajt: korrik, gusht e shtator; dhe brenda datës 20 dhjetor, për muajt: tetor, nëntor dhe dhjetor.
2. Në rast se aktiviteti i biznesit hapet, mbyllet apo pezullohet gjatë vitit fiskal, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël është proporcional me kohën e zhvillimit të aktivitetit dhe llogaritet në bazë të vetëdeklarimit të tatimpaguesit. Për tatimpaguesit e regjistruar për herë të parë gjatë vitit, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin llogaritet në bazë të qarkullimit dhe të fitimit të tatueshëm, të parashikuar nga vetë tatimpaguesi, për periudhën nga data e regjistrimit deri në fund të vitit të parë kalendarik.
3. Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është i detyruar që deri më 10 shkurt të vitit që pason periudhën tatimore të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, tatimi për t'u paguar, si dhe çdo hollësi tjetër e përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore. Detyrimin për paraqitjen e deklaratës vjetore në afatin e mësipërm e kanë edhe të gjithë tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) milionë lekë.
4. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.
5. Administrata Tatimore Qendrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet. Administrata Tatimore Qendrore,

për shërbimin që kryen, merr një komision. Ky komision llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore, i cili është në masën 1 për qind dhe derdhet në llogari të Administratës Tatimore Qendrore.

## **2. TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME**

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Në taksën mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen :

- a. Taksa mbi ndërtesat,
- b. Taksa mbi tokën bujqësore,
- c. Taksa mbi truallin

### **2.a TAKSA MBI NDËRTE SAT**

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.

Nivelet e taksës mbi ndërtesat sipas kategorive dhe nënkategorive përcaktohen si mëposhtme :

- a) **0,05%** për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) **0,2%** për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) **30%** e shkallës së taksës përkatëse për të gjitha sipërfaqet ndërtimore, për të cilat zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

#### **➤ Sgarime:**

- Taksa mbi ndërtesat për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike , paguhet për cdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitet.
- Taksa për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim, është detyrim vjetor dhe pasqyrohet në faturat tatimore të shitjes të lëshuara nga “Ujësjellës Kanalizime Berat-Kucovë” sh.a, për familjet që kanë kontratë me këtë shoqëri.
- Familjet që nuk kanë kontratë “Ujësjellës Kanalizime Berat-Kucovë” sh.a duhet të kryejnë pagesën e taksës, brenda vitit kalendarik pranë lagjeve dhe njësisë administrative, në të cilat banojnë.

#### **Afatet e pagesë për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike:**

- Kësti i parë, brenda datës 20 Prill
- Kësti i dytë paguhet brenda datës 20 Qershor.
- Nëse subjekti i biznesit hap aktivitet tregëtar pas datës 20 prill, detyrimi tatimor paguhet brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit.
- Nëse subjekti taksapagues hap aktivitetin, pezullon veprimtarinë ose aplikon për c’regjistrim pranë QKB-së gjatë vitit fiskal, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar nivelin e taksës për vitin e plotë kalendarik me numërin e muajve të plotë gjatë të cilave

veprimtaria është kryer( përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë aplikimi për regjistrim, pezullim ose ç' regjistrim) dhe duke e pjestuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

**Përfshihen nga pagimi i taksës mbi ndërtesat :**

- a) pronat e shtetit dhe të njëjësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- e) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”;
- ë) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;
- f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.
- h) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që i përkasin kategorive me status invalid të punës, invalid të luftës, të verbër, veteranë të luftës, të sëmurë para dhe tetraplegjikë, ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë” si dhe familjet me një pjestarë.

**2.b TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE**

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka.

Niveli i kësaj takse për sipërfaqet e tokës bujqësore sipas kategorive përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme :

| Kategoria e tokës bujqësore | Berat Lek/ha/vit | Njësia administrative |       |        |           |
|-----------------------------|------------------|-----------------------|-------|--------|-----------|
|                             |                  | Roshnik               | Sinjë | Otllak | Velabisht |
| III                         |                  |                       |       | 2,800  |           |
| IV                          |                  |                       |       | 2,300  | 2,300     |
| V                           |                  |                       | 1,900 | 1,900  | 1,900     |
| VI                          |                  | 1,600                 | 1,600 | 1,600  | 1,600     |
| VII                         | 1,400            | 1,400                 | 1,400 | 1,400  | 1,400     |

**Sqarime:**

Taksa mbi tokën bujqësore duhet të paguhet brenda vitit kalendarik pranë lagjeve dhe njëjësive administrative, në të cilat banojnë.

### Përfashtohen nga pagimi i taksës mbi tokën bujqësore :

- a. Taksapaguesit që i përkasin kategorive me status invalid të punës, invalid të luftës, të verbër, veteranë të luftës, të sëmurë para dhe tetraplegjikë, ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë” si dhe familjet me një pjestarë.
- b. Sipërfaqet e tokës bujqësore që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

### **2.c TAKSA MBI TRUALLIN**

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.

Niveli i taksës mbi truallin (jo hapësirë publike) përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme :

| KATEGORITË   | Berat      | Njësia administrative |       |        |           |
|--|------------|-----------------------|-------|--------|-----------|
|  |            | Roshnik               | Sinjë | Otllak | Velabisht |
|  | Lek/m2/vit |                       |       |        |           |
| I. Për truallin që përdoret për qëllime banimi nga individët | 0.42       | 0.42                  | 0.42  | 0.42   | 0.42      |
| II .Për truallin që përdoret për qëllime biznesi             | 18         | 18                    | 18    | 18     | 18        |

### Sqarime:

-Taksa mbi truallin që përdoret për qëllime banimi nga individët duhet të paguhet brenda vitit kalendarik pranë lagjeve dhe njësive administrative, në të cilat banojnë.

### **Afatet e pagesë për taksën e truallit që përdoret për qëllime biznesi:**

- Kësti i parë, brenda datës 20 Prill
- Kësti i dytë paguhet brenda datës 20 Qershor.
- Nëse subjekti i biznesit hap aktivitet tregëtar pas datës 20 prill, detyrimi tatimor paguhet brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit.
- Nëse subjekti taksapagues hap aktivitetin, pezullon veprimtarinë ose aplikon për c’regjistrim pranë QKB-së gjatë vitit fiskal, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar nivelin e taksës për vitin e plotë kalendarik me numërin e muajve të plotë gjatë të cilave veprimtaria është kryer( përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë aplikimi për regjistrim, pezullim ose ç’regjistrim) dhe duke e pjestuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

### **3. TAKSA E FJETJES NË HOTEL**

Me "hotel" kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel.

Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës. Niveli i taksës së fjetjes në hotel sipas kategorive përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme :

| KATEGORITË   | Berat | Njësia administrative |       |        |           |
|--|-------|-----------------------|-------|--------|-----------|
|  |       | Roshnik               | Sinjë | Otllak | Velabisht |
|  |       | Lek/për natë fjetje   |       |        |           |
| I. Hotel me 4-5 yje  | 175   | 105                   | 105   | 105    | 105       |
| II. Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin | 70    | 35                    | 35    | 35     | 35        |

#### Afatet e pagesës:

Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë, në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

#### **4. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË**

-Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë, për Bashkinë Berat sipas kategorive dhe nënkategorive përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme :

| KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË   | Niveli i taksës                |
|--|--------------------------------|
| I. Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi   |                                |
| a. Me destinacion banim  | 5 % e çmimit të shitjes për m2 |
| b. Me destinacion garazhd  | 5 % e çmimit të shitjes për m2 |
| c. Me destinacion njësi shërbimi (lokale, dyqane etj...)   | 6 % e çmimit të shitjes për m2 |
| II. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën I, për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të Ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës; si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, |                                |

|   |   |
|---|---|
| a. Ndërtim banimi për përdorim publik (banesa sociale, me kosto të ulët)  | 2 % e vlerës së investimit  |
| b. Ndërtim banimi për përdorim vetjak, ndërtime në sektorin e turizmit, industrisë, bujqësisë, blektorisë, shërbimit apo për përdorim publik, garazhd për përdorim vetjak.  | 3% e vlerës së investimit   |
| c. Ndërtime në sektorin e turizmit në parkun kombëtar të Tomorit  | 2 % e vlerës së investimit  |
| d. Ndërtime çatie në objekte banimi   | 1.5 % e vlerës së investimit  |
| e. Për ndërtesat, që destinohen për qëllime banimi në zonat malore  | 2 % e vlerës së investimit  |
| III. Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte. | 0,1% e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit |
| IV. Për ndërtesat që janë në proces legalizimi  | 0.5% e vlerës së investimit   |

#### **Përfshirjet nga taksa e ndikimit në infrastrukturë :**

- Investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtur të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”.
- Investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.
- Investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përfshirjen nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi për familjet në nevojë, sipas vlerësimit nga drejtoria përkatëse e Bashkisë Berat.

#### **5. TAKSA MBI KALIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME**

Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të të drejtës së pronësisë mbi to. Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Baza e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet.

Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij sipas tabelës. Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë, për Bashkinë Berat sipas kategorive dhe nënkategorive përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme :

| KATEGORITË                         | Berat  | Njësia administrative |       |        |           |
|------------------------------------|--------|-----------------------|-------|--------|-----------|
|                                    |        | Roshnik               | Sinjë | Otllak | Velabisht |
|                                    | Lek/m2 |                       |       |        |           |
| I. Ndërtesa banimi                 | 300    | 100                   | 100   | 100    | 100       |
| II. Ndërtesa për tregti të jashtme | 700    | 300                   | 300   | 300    | 300       |
| III. Ndërtesa të tjera             | 500    | 200                   | 200   | 200    | 200       |

**Sqarime:**

- Agjent tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Agjensia Shtetërore e Kadastrës Berat e çila përfton 3% të shumës së arkëtuar.
- Të ardhurat nga taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme derdhen për llogari të buxhetit të Bashkisë Berat në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

**Përfshihen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:**

- Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;
- personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”;
- subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:
  - institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
  - bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

**6. TAKSA E TABELËS**

Taksa e tabelës zbatohet për të gjithë subjektet, të cilët vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

Niveli i taksës së tabelës sipas kategorive dhe nënkategorive përkatëse përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabelat kategorizohen në:

- Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtarinë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logo dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një tabele identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë.



b) Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.

c) Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose jo ballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si në tarraca, llozhe, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare, etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.

ç) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

| Nr  | Pershkrimi   | Njesia                          | Vlera  |
|-----|--|---------------------------------|--------|
| a.  | Deri në 2m <sup>2</sup>  | Leke/ m <sup>2</sup> /vit       | 0      |
| b.  | Mbi 2 m <sup>2</sup> deri në 10 m <sup>2</sup>   |                                 |        |
|     | E thjeshtë pa ndricim  | Leke/ m <sup>2</sup> /vit       | 10 000 |
|     | Me ndricim të thjeshtë   | Leke/ m <sup>2</sup> /vit       | 15 000 |
|     | Elektronike  | Leke/ m <sup>2</sup> /vit       | 20 000 |
| c.  | Mbi 10 m <sup>2</sup> deri në 20 m <sup>2</sup>  |                                 |        |
|     | E thjeshtë pa ndricim  | Leke/ m <sup>2</sup> /vit       | 8500   |
|     | Me ndricim të thjeshtë   | Leke/ m <sup>2</sup> /vit       | 12 750 |
|     | Elektronike  | Leke/ m <sup>2</sup> /vit       | 17 000 |
| ç.  | Mbi 20 m <sup>2</sup> deri në 40 m <sup>2</sup>  |                                 |        |
|     | E thjeshtë pa ndricim  | Leke/ m <sup>2</sup> /vit       | 5500   |
|     | Me ndricim të thjeshtë   | Leke/ m <sup>2</sup> /vit       | 8250   |
|     | Elektronike  | Leke/ m <sup>2</sup> /vit       | 11 000 |
| d.  | Mbi 40 m <sup>2</sup>  |                                 |        |
|     | E thjeshtë pa ndricim  | Leke/ m <sup>2</sup> /vit       | 4000   |
|     | Me ndricim të thjeshtë   | Leke/ m <sup>2</sup> /vit       | 6000   |
|     | Elektronike  | Leke/ m <sup>2</sup> /vit       | 8000   |
| II  | Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formë dhe përmasa e tabelave për orientim. |                                 |        |
|     | Tabela identifikuese   | Leke/ m <sup>2</sup> /vit       | 120    |
| III | Tabela për qëllime reklamimi e lëvizshme e pa lëvizshme deri në tavanin ,aksimal 35 m <sup>2</sup>                                   |                                 |        |
|     | E thjeshtë( me/ pa ndricim)  | Leke/ m <sup>2</sup> /vit       | 22 500 |
|     | Elektronike  | Leke/ m <sup>2</sup> /vit       | 45 000 |
| IV  | Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura , spektakle stenda reklamuese, banderola etj.                                |                                 |        |
|     | Të të gjitha llojeve dhe përmasave   | 1000 Leke/ m <sup>2</sup> /ditë |        |

**Sqarime:**

- Në llogaritjen e taksës për tabelat më të mëdha se 10 m<sup>2</sup> , shumës së taksës së llogaritur për sipërfaqe deri në 10 m<sup>2</sup> do ti shtohet, shuma e taksës e llogaritur për diferencën e sipërfaqes së mbi 10 m<sup>2</sup> të shumëzuar me tarifën përkatëse të taksës.
- Për subjektet taksapaguese që vendosin më shumë se një tabelë identifikuese, vetëm njëra nga dy tabelat identifikuese do të konsiderohet si e tillë, kurse tabela tjetër do të konsiderohet si reklamë.
- Cdo tabelë reklamimi që kalon sipërfaqen 35 m<sup>2</sup> , do të konsiderohet sikur është 35 m<sup>2</sup> dhe shuma e taksës llogaritet dhe paguhet vetëm për këtë sipërfaqe, pavarësisht madhësisë së saj në m<sup>2</sup> .
- Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit, apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës, shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga germa të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura, apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si mur, fasadë të jashtme të çdo lloji, shtyllë, kollonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë të shkruar, stampuar, apo pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi një sipërfaqe ekzistuese, si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zenë të gjitha shkronjat, figurat, logo dhe simbolet që formojnë tabelën. Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe germa, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produktesh apo shërbimesh që furnizohen nga vetë njësia ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori table. Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi. Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një table identifikuese, përveç atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo në njësinë apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet më pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij. Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori table

#### Afatet e pagesës

- Taksa e tabelës paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin si dhe për çdo tabelë të vendosur.
- Detyrimi për taksën e tabelës paguhet me dy këste:
  - Kësti i parë, brenda datës 20 Prill.
  - Kësti i dytë, brenda datës 20 Qershor
- Nëse subjekti i biznesit hap aktivitet tregtar pas datës 20 Prill, detyrimi tatimor paguhet brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit.
- Nëse subjekti taksapagues hap aktivitet, pezullon veprimtarinë ose aplikon për ç' regjistrim pranë QKB-së gjatë vitit fiskal, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar nivelin e taksës për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është

kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë aplikimi për regjistrim, pezullim ose ç' regjistrim) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

## II. TARIFAT VENDORE

### 1. TARIFA E PASTRIMIT E LARGIMIT TË MBETURINAVE DHE MIRËMBATJES SË HAPËSIRAVE PUBLIKE.

Niveli i tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave dhe mirembajtjes së hapësirave publike sipas kategorive dhe nënkategorive përkatëse përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme :

| KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË  | Njësia administrative |         |         |         |           |
|---|-----------------------|---------|---------|---------|-----------|
|   | Berat                 | Roshnik | Sinjë   | Otllak  | Velabisht |
|   | Lek/vit               |         |         |         |           |
| <b>I. FAMILIARËT</b>  |                       |         |         |         |           |
| a. Për çdo familje  | 1,800                 | 1,400   | 1,400   | 1,400   | 1,400     |
| b. Kryefamiljarët që i përkasin kategorive me status invalid të punës, invalid të luftës, të verbër, veteranë të luftës, të sëmurë para dhe tetraplegjikë, ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë” si dhe familjet me një pjestarë. | 900                   | 700     | 700     | 700     | 700       |
| c. Personat që përfitojnë pension pleqërie, kur familja e tyre përbëhet çift pensionistësh.   | 1,300                 | 1,200   | 1,200   | 1,200   | 1,200     |
| <b>II. SUBJEKTE TË BIZNESIT TË VOGËL</b>  |                       |         |         |         |           |
| a.Restorant, Ushqim i shpejtë, Piceri   | 21,000                | 14,000  | 14,000  | 15,000  | 15,000    |
| b.Prodhim   | 21,000                | 14,000  | 14,000  | 15,000  | 15,000    |
| c.Shërbime  | 9,000                 | 9,000   | 9,000   | 9,000   | 9,000     |
| ç.Transport   | 9,000                 | 9,000   | 9,000   | 9,000   | 9,000     |
| d.Shitje me pakicë & Ushqimore  | 18,000                | 13,000  | 13,000  | 15,000  | 15,000    |
| e.Bar- kafe   | 18,000                | 10,000  | 10,000  | 13,000  | 13,000    |
| f.Profesione të lira  |                       |         |         |         |           |
| - Noter, farmaci, avokat, permbarues, stomatolog, labratorë mjekësore dhe dentar  | 20,000                | 20,000  | 20,000  | 20,000  | 20,000    |
| - Profesione te lire te tjera   | 11,000                | 11,000  | 11,000  | 11,000  | 11,000    |
| g.Ambulant  | 3,400                 | 1,300   | 1,300   | 1,300   | 1,300     |
| <b>III. SUBJEKTE TË BIZNESIT TË MADH</b>  |                       |         |         |         |           |
| a.Prodhim   | 83,000                | 83,000  | 83,000  | 83,000  | 83,000    |
| b.Ndërtim   | 110,000               | 110,000 | 110,000 | 110,000 | 110,000   |
| c.Transport   | 22,000                | 22,000  | 22,000  | 22,000  | 22,000    |
| ç.Import eksport , shërbime, tregti.  | 50,000                | 50,000  | 50,000  | 50,000  | 50,000    |
| d.Per subjekte që nxjerrin gurin ranor  | 100,000               | 100,000 | 100,000 | 100,000 | 100,000   |
| e. Banka dhe institucionet financiare   | 70,000                | 70,000  | 70,000  | 70,000  | 70,000    |
| f. OJF  | 16,000                | 16,000  | 16,000  | 16,000  | 16,000    |
| <b>IV. INSTITUCIONE SHTETËRORE</b>  |                       |         |         |         |           |
| a. Për çdo institucion shtetëror me numër të punësuarish ≤ 5 vetë   | 27,000                | 27,000  | 27,000  | 27,000  | 27,000    |

|   |        |        |        |        |        |
|---|--------|--------|--------|--------|--------|
| b. Për çdo institucion shtetëror me numër të punësuarish 5 deri 20 vetë | 45,000 | 45,000 | 45,000 | 45,000 | 45,000 |
| c. Për çdo institucion shtetëror me numër të punësuarish > 20 vetë      | 77,000 | 77,000 | 77,000 | 77,000 | 77,000 |

## 2. TARIFA E NDRICIMIT PUBLIK

| KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË  | Njësia administrative |         |        |        |           |
|---|-----------------------|---------|--------|--------|-----------|
|   | Berat                 | Roshnik | Sinjë  | Otllak | Velabisht |
|   | Lek/vit               |         |        |        |           |
| <b>I. FAMILIARËT</b>  |                       |         |        |        |           |
| a. Për çdo familje  | 1,300                 | 1,000   | 1,000  | 1,000  | 1,000     |
| b. Kryefamiljarët që i përkasin kategorive me status invalid të punës, invalid të luftës, të verbër, veteranë të luftës, të sëmurë para dhe tetraplegjikë, ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë” si dhe familjet me një pjestarë. | 650                   | 500     | 500    | 500    | 500       |
| c. Personat që përfitojnë pension pleqërie, kur familja e tyre përbëhet nga çift pensionistësh .  | 1,200                 | 500     | 500    | 500    | 500       |
| <b>II. SUBJEKTE TË BIZNESIT</b>   |                       |         |        |        |           |
| a. Për çdo subjekt të biznesit të vogël   | 8,000                 | 2,000   | 2,000  | 3,000  | 3,000     |
| b. Për çdo subjekt Ambulant   | 6,000                 | 2,000   | 2,000  | 3,000  | 3,000     |
| c. Për çdo subjekt biznes i madh  | 12,000                | 12,000  | 12,000 | 12,000 | 12,000    |
| ç. Për institucionet shtetërore   |                       |         |        |        |           |
| -Për çdo institucion shtetëror me numër të punësuarish ≤ 5 vetë   | 8,000                 | 8,000   | 8,000  | 8,000  | 8,000     |
| - Për çdo institucion shtetëror me numër të punësuarish mbi 5 vete  | 12,000                | 12,000  | 12,000 | 12,000 | 12,000    |
| d.OJF   | 12,000                | 12,000  | 12,000 | 12,000 | 12,000    |

## 3. TARIFA E GJELBËRIMIT PUBLIK

Niveli i tarifës së gjelbërimit publik sipas kategorive dhe nënkategorive përkatëse përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme :

| KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË | Njësia administrative |         |       |        |           |
|------------------------------|-----------------------|---------|-------|--------|-----------|
|                              | Berat                 | Roshnik | Sinjë | Otllak | Velabisht |
|                              | Lek/vit               |         |       |        |           |
| <b>I. FAMILIARËT</b>         |                       |         |       |        |           |

|  |        |        |        |        |        |
|--|--------|--------|--------|--------|--------|
